



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR  
TIRANE

Nr.717 S.P/Nr.944 Regj Them      Nr. 372 Vendimi  
Dt.17.01.2022/Dt.17.02.2022      Dt.17.02.2022

**V E N D I M**

**“NË EMËR TË REPUBLIKËS“**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga,

**GJYQTAR GERD HOXHA**

asistuar prej sekretares gjyqësore **Juna Sanxhaku**, sot më datë **17 shkurt 2022**, me kërkesën e **Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë**, përfaqësuar nga prokurori **Z.Enklid Gjini** në përfundim të shqyrtimit gjyqësor në seancë gjyqësore publike, të çështjes penale nr.717 akti, në ngarkim të

**Të pandehurit:** **Martin Mema alias Geri Cano**, i biri i Edmond dhe Odeta, i dtl.21.01.1987, lindur dhe banues në Tiranë, Rr.“Siri Kodra”, banese private, shqiptar, i martuar, me arsim të mesëm, i dënuar, hetuar me masë sigurimi “*arrest në burg*“, i mbrojtur nga *Av.Donata Lepenica*.

**Akuzuar :** Për veprën penale “*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*”, të parashikuara nga neni 283/1 i K.Penal.

Pushimi i procedimit penal për kryerjen e veprës penale “*Falsifikimi i monedhave*” të parashikuar nga neni 183 i K.Penal.

Në përfundim të hetimit gjyqësor Gjykata, pasi administroi provat shkresore; dëgjoji prokurorin, i cili kërkoi :

- Deklarimin fajtor të të pandehurit **Martin Mema** për kryerjen e veprës penale të “*Prodhim dhe shitja e lëndve narkotike*”, parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal dhe dënimin e tij me **5 (pesë) vjet burgim**.
- Aplikimin e nenit 406 të K.Pr.Penale, sipas kërkesës së palës gjatë gjykimit.
- Në aplikim të nenit 59 të K.Penal të urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të pjesës së mbetur pa vuajtur të dënimit me burgim ndaj të pandehurit Martin Mema, duke e vënë në provë të pandehurin për një periudhë kohe prej 4 (katër) vitesh me kusht që gjatë kësaj kohe i pandehuri të mos kryejë veprë tjetër penale dhe të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës në vëndbanim e të pandehurit.
- Pushimin e akuzës për veprën penale “*Falsifikim i dokumentave*”, parashikuar nga neni 183 K.Penal, në ngarkim të personit nën hetim Martin Mema.

- Në aplikim të nenit 190 pika ç, aparat telefon celular tip “Samsung” model S20, një automjet “Alfa Romeo” me targa AB 207 AP, 2 kartmonedha me prerje 5 000 lekëshe dhe një 2 000 lekëshe, si dhe një aparat regjistruar DVR t’i kthehen pronarit të ligjshëm, nëse nuk janë objekt i ndonjë konflikt tjetër.
- Në aplikim të nenit 190 pika b, të urdhërohet asgjësimi i lëndës narkotike të sekuestruar të llojit kokainë në masën 2.4 (dy pikë katër) gramë; dy pjatave porcelani ngjyre e bardhë; kartmonedhës 500 euro të falsifikuar si edhe një peshoreje elektronike.
- Pagimin e shpenzimeve procedurale në ngarkim të të pandehurit.

Dëgjoi mbrojtësen dhe të pandehurin, që u shpreh shumë i penduar dhe kërkoi një masë më të butë se prokurori ;  
si dhe pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi

### V Ë R E N

Se, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë është sjellë për gjykim çështja penale në ngarkim të të pandehurit Martin Mema, akuzuar për veprën penale të “*Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve*“, parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal dhe pushimin e procedimit penal në ngarkim të shtetasit Martin Mema, për veprën penale “*Falsifikim i monedhave*”, parashikuar nga neni 183 të Kodit Penal.

Nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi se, me datë 10.08.2021, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë mbi bazën e materialit kallëzues të dërguar nga Drejtoria Vendore Policisë Tiranë, Sektori i Narkotikëve ka regjistruar Procedimin penal numër 5656, që bën fjalë për veprën penale “*Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike*” në ngarkim të shtetasit Martin Mema e parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe *Falsifikim i monedhave*”, parashikuar nga neni 183 të Kodit Penal.

Nga hetimet paraprake të kryer në lidhje me këtë procedim penal ka rezultuar e provuar se, më datë 09.08.2021 rreth orës 21:15 shërbimet e policisë janë vendosur në rrugën “Siri Kodra” Tiranë, për verifikimin e një informacioni se, shtetasi Martin Mema merrej shitje lënde narkotike. Në rrugë është konstatuar automjeti me targë AB207AP me drejtues mjeti shtetasin Martin Mema. Shërbimet e policisë i janë afruar automjetit dhe i kanë bërë shenjë ndalimi drejtuesit të automjetit, pasi i janë prezantuar si punonjës policie. Ata i kanë kërkuar shtetasit Martin Mema të dalë jashtë automjetit.

Pasi ka dalë nga makina, nga punonjësit e policisë është ushtruar kontroll fizik ndaj shtetasit Martin Mema dhe është konstatuar se brenda gojës mbante një qese transparente të mbyllur me djegie nga njëra anë, brenda së cilës kishte material pluhur të bardhë e dyshuar lënde narkotike *kokainë*, të cilën e ka nxjerrë më pas nga goja.

Duke qenë në kushtet e flagrancës, nga policia gjyqësore u ushtrua kontroll në banesën e shtetasit Martin Mema. Në dhomen e gjumit të tij, në një dollap u gjet një kavanoz qelqi me kapak ngjyre blu, brenda së cilit kishte një qese transparente me sasi materiali si pluhur të bardhë, të dyshuar lëndë narkotike *kokainë*, një peshore elektronike me ngjyre blu dhe gri, me mbetje pluhuri të bardhë, të dyshuar lënde narkotike *kokainë*, si dhe disa qese të vogla plasmasi, të prera në menyre rrethore. Gjithashtu, brenda dollapit u gjet një kuti me mbishkrimin “STR8” brenda së cilës u gjend një kartmonedhë 500 (pesëqind) Euro me numër serial “X03603274706” e dyshuar si falsifikuar.

Nga OPGJ u bë peshimi i qeses transparente, brënda së cilës kishte lëndë të dyshuar narkotike e llojit kokainë, e gjetur gjatë kontrollit fizik të shtetasit Martin Mema dhe rezultoi me peshë të përgjithshme së bashku me ambalazh 0,8 ( zero presje tetë) gramë.

Gjithashtu, nga OPGJ u bë peshimi i qeses transparente brënda së cilës, ka lëndë të dyshuar narkotike të llojit kokainë, që i'u gjetë gjatë kontrollit të banesës së shtetasit Martin Mema dhe rezultoi me peshë të përgjithshme së bashku me ambalazh 2,4 ( dy presje katër) gramë.

Nga OPGJ, për peshoren elektronike dhe pjatat me mbetje pluhuri të bardhë, të dyshuar kokainë, që u gjendën në banesën e shtetasit Martin Mema, u hartua vendimi ekspertimi kimik dhe u dërguan për ekspertim pranë I.P.SH së.

Gjithashtu, nga OPGJ, për kartëmonedhën 500 (pesëqind) euro me numer serial X03603274706 e dyshuar, si e falsifikuar, u hartua vendim ekspertimi teknik dhe u dërgua për ekspertim pranë I.P.SH së.

Për të përcaktuar faktin nëse, i pandehuri është ose jo përdorues i lëndës narkotike, nga OPGJ i është marrë kampioni i urinës shtetasit Martin Mema dhe është dërguar për ekspertim toksikologjik pranë I.M.L-së.

Në këto kushte, shtetasi Martin Mema është arrestuar në flagrancë, i dyshuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 283/1 dhe 183 të KP. Ky arrestim është vlerësuar i ligjshëm nga Gjykata me vendimin e saj nr.1368Akti, dt.12.08.2021, me të cilin ka caktuar edhe masën e sigurimit “arrest në burg”, për këtë shtetas.

Në vijim të hetimeve, Martin Mema është pyetur nga OPGJ në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, ku ka deklaruar se, lëndë narkotike e gjetur është e tij, pasi është përdorues i saj. Përsa i përket peshores elektronike që i'u gjet në banesë ai ka deklaruar se e ka blerë për të vërtetuar peshën e lëndës narkotike kokainë, që blinte për përdorim vetjak.

Në lidhje me kartëmonedhën e dyshuar që është e falsifikuar që ju gjend në banesë, Martin Mema ka deklaruar se, ka dijoni që është e falsifikuar dhe se ia ka dhënë një shoku i tij përpara katër vitesh. Ai e ka mbajtur në banesë, pa patur qëllim për ta përdorur.

Shtetasi Martin Mema ka sqaruar se, për herë të fundit ka konsumuar lëndë narkotike kokainë përpara katër ditësh nga moment i kontrollit policor.

Në lidhje me këtë ngjarje janë kryer të gjitha veprimet proceduriale, si dhe janë administruar të gjitha akt ekspertimet përkatës si vijon: është administruar akt ekspertimi teknik-kartëmonedhë me Nr.8194 date 20.08.2021, ku është arritur në konkluzionin se; Kartëmonedha e prerjes 500 (peseqind) euro numër serie me X03603274706, objekt ekspertimi është tërësisht e falsifikuar. Si metodë falsifikimi është prodhimi i saj me anën e makina "Offset".

Gjatë hetimit është administruar akti i ekspertimit kimik Nr.11293, datë 05.11.2021, ku është arritur në konkluzionin se: “*Analiza me GC/MS për mbetje në objektet, objekt ekspertimi treguan për mbetje të kokainës*”.

Është administruar akti i ekspertimit kimik Nr.11294, date 05.11.2021, ku është arritur në konkluzionin se: “*Analiza me GC/MS për material objekt ekspertimi të numërtuar nga ana jonë 1,2 dhe 3 tregoi për praninë e kokainës. Pësja e pluhurit pa ambalazh për materialin e numërtuar është 0.616 gramë. Pësja e pluhurit pa ambalazh për materialin e numërtuar 2 është 0.363 gramë. Pësja e pluhurit pa ambalazh për materialin e numërtuar 1.503 gramë*”.

Sipas aktit të ekspertimit toksikologjiko-ligjor nr. 2009 datë 26.08.2021, është arritur në konkluzionin se, në mostrën e urinës të marrë shtetasit Martin Mema, mbyllur në kontenier dhe të futur në qese prove me Nr B20000408, nuk u zbulua prania e produkteve të metabolizmit të kokainës ( benzoilekgonine) në organizmin e njeriut.

Sipas akt ekspertim aparati celular dhe kartë SIM me Nr. 12780 datë 21.12.2021 është arritur në konkluzionin se: *Aparat telefoni celular objekt ekspertimi i markes Samsung, model SM-G986B/DS me numer IMEI FIZIK 359847101060581, u ekzaminua pjesërisht, pasi telefoni celular është i mbyllur me kod sigurie dhe ekzaminimi i plote i tij, nuk mund te kryhet pa na u venë në dispozicion kodi i tij i sigurisë.*

Nga analizimi i të dhënave të ekstraktuara nga memoria e aparatit telefon objekt ekspertimi u konstatuan të dhëna si: informacion i përgjithshëm për aparatën celular të dhëna në lidhje me aplikacionet e instaluar, të dhëna në lidhje me disa pajisje më të cilat, telefoni është lidhur me anë të opsionit "Bluetooth, të dhëna në lidhje me procesin e ndezjes së telefonit në kohë të ndryshme të dhëna në lidhje me rrjetet eireless, me të cilin është lidhur telefoni në kohë të ndryshme, skedare audio, skedare fotografi, skedare video, llogari perdoruesish, passëord (token), disa të dhëna në lidhje me aktivitetin në internet nga përdoruesi, thirrje telefonike, koordinata gjeografike, vendndodhje të ardhura nga aplikacioni "Google Maps" etj.

Në aparatën celular objekt ekspertimi, përveç kartës SIM të konstatuar në folenë përkatesë në momentin e ardhjes për ekspertim, konstatohet e përdorur edhe një kartë Sim tjetër e kompanisë telefonike celulare "Vodafone Albania" sha me numer serial (ICC ID): (89355020000341710117)

Me anë të numrit serial (ICC ID) kompania ofruese e shërbimit të telefonisë celulare bën identifikimin e numrit të telefonit, abonentit dhe të dhënave që lidhen me të, si tabulatet e bisedave telefonike etj. Nga analizimi i të dhënave të ekstraktuara nga memoria e kartës SIM objekt ekspertimi të kompanisë celulare "Albetelecom Albania" me numer serial ICCID 89355030000072985886, u konstatuan informacione të përgjithshme për kartën SIM, të dhëna në lidhje me antenën e fundit telefonike më të cilën është lidhur për herë të fundit karta sim dhe kontakte telefonike.

Në memorien e kartës SIM , nuk u konstatuan thirrje të dërguara ose të tentuara për tu dërguar, si dhe nuk u arrit të rikuperohen mesazhe SMS të fshirë. Kartat SIM ruajnë në memorien e tyre vetëm numra kontakti, thirrjet e dërguara ose të tentuara për t'u bërë dhe mesazhe SMS. Per kartat SIM, programet ekzaminuese, mund të rikthejnë vetëm SMS-të fshira, nëse në zonat ku kanë qënë të ruajtura këto SMS, nuk janë shkruar SMS të reja.

Nga kqyrja e të dhënave të pasqyruara në DVD-të venë në dispozicion me akt ekspertimin aparati celular dhe kartë SIM në ngarkim të shtetasit Martin Mema me Nr. 12780 datë 21.12.2021, sipas procesverbalit të kqyrjes të datës 29.12.2021 dhe pas analizimit të përmbajtjes së dosjes me emertimin "Samsung 820 SM-9868 DS, UFDR, u konstatuan disa skedare fotografi të cilat, sipas metadatave që mbajnë, ju përkasin disa fotove te realizuara me "Screenshot" nga përdoruesi i telefonit. Nga analizimi i përmbajtjes vizuale të fotove (screenshot) nuk u konstatuan komunikime me interes për hetimin.

Nga sa u argumentua më sipër bazuar dhe në provat e administruara gjatë fazës së hetimit paraprak Prokuroria pretendon se, i pandehuri Martin Mema ka konsumuar elementët e vepres penale të "*Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike*" parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal. Për këto arsye kërkon që çështja të kalojë për gjykim.

Gjithashtu, bazuar në aktet e administruara gjatë këtij hetimi Prokuroria kërkon pushimin e procedimit penal në ngarkim të shtetasit Martin Mema, për veprën penale "*Falsifikim i monedhave*", parashikuar nga neni 183 të Kodit Penal. Prokurori ka arsyetuar se, nuk ka prova që vërtetojnë se, i pandehuri ka dashur ta hedhë në qarkullim kartëmonedhën 500 euro. Gjithashtu, nuk ka prova se, i pandehuri e ka falsifikuar këtë kartëmonedhë.

Faktet e mësipërme u vërtetuan nga: Proces-verbali i kapjes ne flagrante date 09.08.2021; procesverbalin e sekuestrimit date 10.08.2021, procesverbali i kontrollit te baneses date 09.08.2021, akti i ekspertimit mjeko-ligjor kimik te lendes nr. 11293, date 05.11.2021, Akt ekspertimit Teknik-kartemonedhe me Nr. 8194, date 20.08.2021 si dhe në tërësi aktet e procedimit penal Nr. 5656 të vitit 2021.

Në lidhje me kërkesën e Prokurorisë për dërgimin në gjyq të procedimit penal nr.5656/2021, në ngarkim të pandehurit Martin Mema i akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike*”, parashikuar nga neni 283/1 i KP, Gjykata çmon të marrë në analizë disa elementë formalë dhe thelbësorë të kërkuara nga ligji procedural penal.

Konkretisht, në nenin 331 të K.Pr.Penale, janë parashikuar në mënyrë të qartë elementët formalë që duhet të përmbajë kërkesa për kalimin e çështjes në gjyq. Në interpretim të dispozitës ligjore të mësipërme në raport me elementët, që përmban kërkesa objekt gjykimi Gjykata vlerëson se, kërkesa i plotëson të gjitha elementët formalë të parashikuar nga ligji, pasi përmban gjeneralitetet e të pandehurit, rrethanat e faktit dhe burimet e provës, cilësimin juridik të veprës penale, kërkimin për kalimin e çështjes në gjyq si dhe datën dhe nënshkrimin e prokurorit.

Veç sa më sipër, ligjvënësi e ka kushtëzuar vlefshmërinë e kërkesës për kalimin e çështjes në gjyq me respektimin e përcaktimeve të bëra në paragrafët 2, 3, 4 të nenit 327 të K.Pr.Penale. Konkretisht në nenin 331/2 i K.Pr.Penale, është parashikuar në mënyrë të qartë se: “...2. *Kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq është e pavlefshme kur nuk respektohen përcaktimet e paragrafëve 2, 3 dhe 4 të nenit 327 të këtij Kodi*”.

Për të vlerësuar vlefshmërinë e kërkesës së paraqitur, Gjykata mban në vëmendje përmbajtjen e paragrafëve 2, 3, dhe 4 të nenit 327 të K.Pr.Penale.

Në interpretim të dispozitave ligjore të mësipërme, në raport me aktet e paraqitura në mbështetje të kërkesës për kalimin e çështjes në gjyq Gjykata vlerëson se, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka respektuar parashikimet e nenit 327 të K.Pr.Penale. Konkretisht, referuar aktit “*Njoftim për përfundimin e hetimeve*” rezulton se, i pandehuri është njoftuar për përfundimin e hetimeve.

Gjithashtu, rezulton se në aktin e njoftimit për përfundimin e hetimeve është pasqyruar një përshkrim i përmbledhur i faktit për të cilin po procedohet, koha dhe vendi i kryerjes dhe cilësimi juridik i tij. Në kuadër të elementëve të tjerë të domosdoshëm që duhet të përmbajë akti i njoftimit për përfundimin e hetimeve, të pandehurit i është bërë me dije e drejta për t’u njohur me aktet dhe për të marrë kopje të tyre, e drejta që të paraqesë memorie dhe dokumenta, e drejta për të kërkuar kryerjen e hetimeve shtesë apo të bëjë deklarime dhe të kërkojë të merret në pyetje. Akti i njoftimit është nënshkruar nga i pandehuri. Për rrjedhojë, nuk ka dyshime në lidhje me marrjen dijeni dhe rezulton se, i pandehuri ka deklaruar se janë njohur me të gjitha aktet e hetimeve paraprake, nuk kërkon të marrë kopje të tyre dhe as të bëhen veprime hetimore shtesë, si dhe është shprehur dakort për dërgimin e çështjes në gjyq, pasi nuk ka prova për të paraqitur. Nga ana tjetër, Gjykata vlerëson se, kërkesës i janë bashkëlidhur të gjitha aktet dhe provat që përmban fashikulli i hetimit si dhe aktet e kryera para gjyqtarit të hetimeve paraprake, sipas parashikimit të nenit 331 pg. 4 i K.Pr.Penale.

Sa më sipër Gjykata vlerëson se, nga pikpamja formale, kërkesa për kalimin e çështjes në gjyq përmban të gjitha elementët e kërkuar nga ligji dhe për rrjedhojë, ajo është një kërkesë e vlefshme.

Në kuadër të vlerësimit të elementëve thelbësorë të kërkesës, Gjykata vlerëson se në rastin konkret, hetimet e kryera nga organi i Prokurorisë janë të plota. Nga vlerësimi në tërësi i akteve

të ndodhura në fashikullin e hetimeve paraprake arrihet në përfundimin se, Prokuroria ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore në kuadër të grumbullimit të provave, për të provuar faktin penal në ngarkim të të pandehurit Martin Mema.

Nga ana tjetër, mbrojtësi dhe i pandehuri deklaruan në seancë paraprake se, nuk kanë asnjë pretendim në lidhje me pavlefshmërinë e akteve apo, papërdorshmërinë e provave.

Gjithashtu, pasi analizoi kryesisht aktet e ndodhura në fashikullin e hetimit dhe përmbajtjen e tyre, Gjykata nuk konstatoi akte absolutisht apo, relativisht të pavlefshme në kuptim të neneve 128/a dhe 129 të K.Pr.Penale.

Sa më sipër Gjykata vlerëson se, kërkesa e paraqitur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë për kalimin në gjyq të procedimit penal nr.5656/2021, në ngarkim të Martin Mema, të akuzuar respektivisht për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283/1 të Kodit Penal, i plotëson të gjitha elementët formalë për vlefshmërinë e saj. Gjithashtu, hetimet e kryera nga ana e Prokurorisë janë të plota. Gjykata nuk u konstatoi akte absolutisht apo, relativisht të pavlefshme apo, prova të papërdorshme.

Në këto kushte Gjykata çmon se, kërkesa e Prokurorisë është e bazuar në ligj dhe duhet të pranohet duke vendosur dërgimin në gjyq të kësaj çështjeje penale.

Sa i përket kërkesës së Prokurorisë për pushimin e procedimit penal për veprën penale të parashikuar nga neni 283/1 i KP Gjykata vëren se : Gjykata vëren se, në nenin 329/a të K.Pr.Penale përcaktohet që: *“Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për kundërvajtje penale, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur: a) del qartë se fakti nuk ekziston; b) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale; c) viktima nuk ka bërë ankim ose heq dorë nga ankimi në rastet që procedimi fillon me kërkesën e tij; ç) personi nuk mund të merret si i pandehur ose nuk mund të dënohet; d) ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose për të cilin ndjekja penale nuk duhej të fillohej ose nuk duhet të vazhdojë; dh) del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai; e) me vendim të formës së prerë i pandehuri është gjykuar për të njëjtën vepër penale; e) i pandehuri vdes; f) në rastet e tjera të parashikuara me ligj”*.

Referuar kompetencave ekskluzive të parashikuara në K.Pr.Penale, Prokuroria ka paraqitur para gjyqtarit të seancës paraprake kërkesën me objekt: *“Pushimin e procedimit penal për veprën penale të “Falsifikimit të monedhave”, parashikuar nga neni 183 i KP”* me arsyetimin se, ndodhemi në kushtet e parashikimeve ligjore të nenit 328 pika 1, germa “b” e K.Pr.Penale.

Gjykata vëren se, arsyetimi i bërë nga prokurori është i drejtë dhe i bazuar në prova e në ligj. Nga akti i ekspertimit Teknik-kartemonedhe konkludohet se ne *“...Kartemonedha e prerjes 500 (peseqind) euro me numer serie X03603274706, object ekspertimi eshte teresisht e falsifikuar”*, por ne kushtet kur nuk është përdorur asnjëherë si kartëmonedhë e falsifikuar pra të mungesës së pasojës, organi i akuzës me të drejtë çmon se ky fakt në vetvete përbën një rrethanë, e cila nuk lejon vazhdimin e ndjekjes penale për faktin penal të parashikuar nga neni 183 i KP. Gjykata vëren se, nuk ka prova që vërtetojnë se, i pandehuri ka dashur ta hedhë në qarkullim kartëmonedhën 500 euro. Gjithashtu, nuk ka prova se, i pandehuri e ka falsifikuar këtë kartëmonedhë. Për pasojë, nuk provohet ekzistenca e konsumimit nag i pandehuri të anës objective të kësaj vepre penale, as falsifikimi nga ana e tij dhe as përdorimi.

Sa sipër, Gjykata bindet se, shtetasi Martin Mema nuk ka konsumuar elementë të vepres penale të *“Falsifikim i monedhave”* parashikuar nga neni 183 të Kodit Penal.Për pasojë, duhet pranuar kërkesa e prokurorit për pushimin e hetimeve ndaj të pandehurit, për këtë vepër penale.

Në lidhje me kërkesën për gjykim të shkurtuar parashtruar nga mbrojtësi dhe i pandehuri Gjykata, bazuar arsyetimin e mësipërm si dhe në nenet 332/dh/2, gërma c) dhe 403 të K.Pr.Penale, vlerëson se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet. Për pasojë, ftoi palët në diskutimin përfundimtar, i cili është përshkruar në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Sa i përket kualifikimit ligjor të veprimeve të kryera më sipër nga i pandehuri Gjykata vëren se, do t'i referohet nenit 283/1 i K.Penal, i cili parashikon se : *“Shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregëtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhe mbajtja, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si dhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin, ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.”*

Nga interpretimi i dispozitës së mësipërme rezulton se ligjvënësi, ka parashikuar një mbrojtje të posaçme juridike të marrëdhënieve që garantojnë shitjen, blerjen, shpërndarjen transportimin, mbajtjen dhe përdorimin sipas dispozitave ligjore përkatëse të lëndëve narkotike e psikotrope, nga veprime të kundraligjshme e shoqërisht të rrezikshme, të cilat ndikojnë drejtëpërdrejtë në shëndetin e personit, funksionimin normal të veprimtarisë së organeve vitale të tij. Sipas kësaj dispozite, veprimet që çënojnë marrëdhëniet e sipërpërmendura passjellin përgjegjësi penale. Këto veprime, për t'u cilësuar si vepër penale nga ligji, duhet që :

- të kenë prekur marrëdhëniet juridike (dispozitat përkatëse ligjore) që rregullojnë shitjen, blerjen, shpërndarjen transportimin, mbajtjen apo përdorimin vetjak të lëndëve narkotike;
- nga ana objektive këto veprime duhet të jenë aktive, me anë të të cilave personi të kryejë shitje, blerje, mbajtje, transportim, tregëtim, shpërndarje, dorëzim apo, përdorim vetjak të lëndëve narkotike, në mënyrë të kundraligjshme e shoqërisht të rrezikshme. Sasia e lëndës narkotike për përdorim vetjak përcaktohet rast pas rasti, në varësi të aftësive fiziko-biologjike të përdoruesit, cilësisë dhe përqëndrimit të lëndës narkotike si dhe periudhës kohore të përdorimit të lëndës narkotike nga ky përdorues. Por, asnjëherë nuk duhet të jetë në disa doza.;
- subjekti që kryen këto veprime duhet të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale, në rastin konkret të ketë mbushur 14 vjeç;
- Veprimet e autorit të veprës penale duhet të kryhen me dashje direkte. Qëllimi dhe motivi nuk kanë rëndësi për cilësimin juridik të veprës por, mbahen parasysht nga Gjykata në caktimin e llojit dhe masës së dënimit.

Në rastin konkret, siç rezultoi nga shqyrtimi gjyqësor, ka rezultuar e provuar se, i pandehuri e ka kryer plotësisht veprën penale të parashikuar nga neni 283/1 i KP. Rrethanat në të cilat është kryer vepra penale dhe provat që vërtetojnë kryerjen e saj janë si më poshtë vijon:

më datë 09.08.2021 rreth orës 21:15 shërbimet e policisë janë vendosur në rrugën "Siri Kodra" Tiranë, për verifikimin e një informacioni se, shtetasi Martin Mema merrej shitje lënde narkotike. Në rrugë është konstatuar automjeti me targë AB207AP me drejtues mjeti shtetasin Martin Mema. Shërbimet e policisë i janë afruar automjetit dhe i kanë bërë shenjë ndalimi drejtuesit të automjetit, pasi i janë prezantuar si punonjës policie. Ata i kanë kërkuar shtetasit Martin Mema të dalë jashtë automjetit.

Pasi ka dalë nga makina, nga punonjësit e policisë është ushtruar kontroll fizik ndaj shtetasit Martin Mema dhe është konstatuar se brenda gojës mbante një qese transparente të mbyllur me djegie nga njëra anë, brenda së cilës kishte material pluhur të bardhë e dyshuar lënde narkotike *kokainë*, të cilën e ka nxjerrë më pas nga goja.



Duke qenë në kushtet e flagrancës, nga policia gjyqësore u ushtrua kontroll në banesën e shtetasit Martin Mema. Në dhomen e gjumit të tij, në një dollap u gjet një kavanoz qelqi me kapak ngjyre blu, brenda së cilit kishte një qese transparente me sasi materiali si pluhur të bardhë, të dyshuar lëndë narkotike *kokainë*, një peshore elektronike me ngjyre blu dhe gri, me mbetje pluhuri të bardhë, të dyshuar lëndë narkotike *kokainë*, si dhe disa qese të vogla plasmasi, të prera në menyre rrethore. Gjithashtu, brenda dollapit u gjet një kuti me mbishkrimin "STR8" brenda së ciles u gjend një kartemonedhë 500 (pesëqind) Euro me numër serial "X03603274706" e dyshuar si falsifikuar.

Nga OPGJ u bë peshimi i qeses transparente, brënda së cilës kishte lëndë të dyshuar narkotike e llojit *kokainë*, e gjetur gjatë kontrollit fizik të shtetasit Martin Mema dhe rezultoi me peshë të përgjithshme së bashku me ambalazh 0,8 ( zero presje tetë) gramë.

Gjithashtu, nga OPGJ u bë peshimi i qeses transparente brënda së cilës, ka lëndë të dyshuar narkotike të llojit *kokainë*, që i'u gjetë gjatë kontrollit të banesës së shtetasit Martin Mema dhe rezultoi me peshë të përgjithshme së bashku me ambalazh 2,4 ( dy presje katër) gramë.

Nga OPGJ, për peshoren elektronike dhe pjatat me mbetje pluhuri të bardhë, të dyshuar *kokainë*, që u gjendën në banesën e shtetasit Martin Mema, u hartua vendimi ekspertimi kimik dhe u dërguan për ekspertim pranë I.P.SH së.

Gjithashtu, nga OPGJ, për kartëmonedhën 500 (pesëqind) euro me numer serial X03603274706 e dyshuar, si e falsifikuar, u hartua vendim ekspertimi teknik dhe u dërgua për ekspertim pranë I.P.SH së.

Për të përcaktuar faktin nëse, i pandehuri është ose jo përdorues i lëndës narkotike, nga OPGJ i është marrë kampioni i urinës shtetasit Martin Mema dhe është dërguar për ekspertim toksikologjik pranë I.M.L-së.

Në vijim të hetimeve, Martin Mema është pyetur nga OPGJ në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, ku ka deklaruar se, lëndë narkotike e gjetur është e tij, pasi është përdorues i saj. Përsa i përket peshores elektronike që i'u gjet në banesë ai ka deklaruar se e ka blerë për të vërtetuar peshën e lëndës narkotike *kokainë*, që blinte për përdorim vetjak.

Në lidhje me kartëmonedhën e dyshuar që është e falsifikuar që ju gjend në banesë, Martin Mema ka deklaruar se, ka dijeni që është e falsifikuar dhe se ia ka dhënë një shoku i tij përpara katër vitesh. Ai e ka mbajtur në banesë, pa patur qëllim për ta përdorur.

Shtetasi Martin Mema ka sqaruar se, për herë të fundit ka konsumuar lëndë narkotike *kokainë* përpara katër ditësh nga moment i kontrollit policor.

Në lidhje me këtë ngjarje janë kryer të gjitha veprimet procedurale, si dhe janë administruar të gjitha akt ekspertimet përkatës si vijon: është administruar akt ekspertimi teknik-kartëmonedhë me Nr.8194 date 20.08.2021, ku është arritur në konkluzionin se; Kartëmonedha e prerjes 500 (peseqind) euro numër serie me X03603274706, objekt ekspertimi është tërësisht e falsifikuar. Si metodë falsifikimi është prodhimi i saj me anën e makina "Offset".

Gjatë hetimit është administruar akti i ekspertimit kimik Nr.11293, datë 05.11.2021, ku është arritur në konkluzionin se: *"Analiza me GC/MS për mbetje në objektet, objekt ekspertimi treguan për mbetje të kokainës"*.

Është administruar akti i ekspertimit kimik Nr.11294, date 05.11.2021, ku është arritur në konkluzionin se: *"Analiza me GC/MS për material objekt ekspertimi të numërtuar nga ana jonë 1,2 dhe 3 tregoi për praninë e kokainës. Pesha e pluhurit pa ambalazh për materialin e numërtuar është 0.616 gramë. Pesha e pluhurit pa ambalazh për materialin e numërtuar 2 është 0.363 gramë. Pesha e pluhurit pa ambalazh për materialin e numërtuar 1.503 gramë"*.



Sipas aktit të ekspertimit toksikologjiko-ligjor nr. 2009 datë 26.08.2021, është arritur në konkluzionin se, në mostrën e urinës të marrë shtetasit Martin Mema, mbyllur në kontenier dhe të futur në qese prove me Nr B20000408, nuk u zbulua prania e produkteve të metabolizmit të kokainës ( benzoilekgonine) në organizmin e njeriut.

Sa më sipër vërtetohet plotësisht se, i pandehuri Martin Mema ka mbajtur për qëllim përdorimi vetjak një sasi lëndë narkotike kokainë gjithsej 3,6 (tre presje gjashtë) gramë. Nga hetimi gjyqësor rezultoi se, ky i pandehuri nuk ka qenë i autorizuar nga ligji apo ndonjë organ tjetër kompetent për të kryer veprimtari shitje, blerje, shpërndarje apo mbajtje, tej dozave të lejuara për përdorim vetjak, të lëndës narkotike “*kokainë*”.

I pandehuri është shprehur shumë i penduar për veprimin e kryer dhe është duke u rehabilituar ndaj varësia që ka ndaj saj. Edhe gjatë gjykimit, i pandehuri u shpreh mjaft i penduar për kryejën e veprës penale.

Gjykata vëren se, të qenit përdorues të lëndës narkotike do të mbahet parasysh si lehtësuese, në caktimin e llojit dhe masës së dënimit që do të japë ndaj të pandehurit por, nuk e shkarkon këtë të fundit nga përgjegjësia penale. Legjislacioni penal në fuqi nuk bën dallim mes motiveve, që e shtyjnë një person të shpërndajë, të mbajë, përdorë, dërgojë, dorëzojë apo, të shesë lëndë narkotike, të cilido lloj qofshin, të lehta apo rënda. Cilido qoftë motivi apo qëllimi, që e shtyn një person të shpërndajë, shesë, transportojë, mbajë, prodhojë, përdorë (*përdorim në sasi të vogla, për përdorim vetjak, nuk është i dënueshëm penalisht por, sasia çmohet rast pas rasti*) lëndë narkotike, pa lejen e organeve kompetente, nuk e shkarkon këtë person nga përgjegjësia penale. Në këtë kontekst Gjykata vëren se, i pandehuri Martin Mema pavarësisht se, e dinte që mbajtja dhe përdorimi i lëndëve narkotike dënohen nga ligji penal, ka mbajtur me vete, derisa është kapur nga punonjësit e policisë më dt.09.08.2021 sasi lëndës narkotike “*kokainë*” prej 08,8 dhe 2,4 gramë (*pa ambalazh*), tej kufijve të lejuara nga ligji për përdorim vetjak.

Në këto kushte, Gjykata çmon se, i pandehuri ka konsumuar anën objektive dhe subjektive të veprës penale të “*Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve*”, parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal, në formën e **mbajtjes** tej sasisë për përdorim vetjak. Ndërkohë që, nuk ka asnjë provë që të vërtetojë se, ky i pandehur ka konsumuar forma të tjera të kësaj vepre penale, përveç mbajtjes për përdorim vetjak.

Gjithashtu gjatë gjykimit rezultoi se, i pandehuri është mendërisht i përgjegjëshëm dhe mbi 14 vjeç, duke qenë kështu subjekt i veprës penale të “*Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve*”, të parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal.

Sa më sipër Gjykata, në vështrim të nenit 283/1 të K.Penal, e gjen fajtor të pandehurin Martin Mema për veprën penale të “*Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve*”.

Për sa i përket llojit dhe masës së dënimit, Gjykata çmon se duhen mbajtur parasysh këto rrethana :

- Rrezikshmërinë relativisht të lartë të veprës penale, për të cilën ligjvënësi ka parashikuar një dënim nga pesë gjer në dhjetë vjetë burgim.
- Faktin se, kjo vepër penale është kryer nga i pandehuri Martin Mema me dashje direkte, nëpërmjet formës së mbajtjes tej përdorimit vetjak.
- Gjykata ka parasysh faktin se, i pandehuri deklaroi se, është përdorues i lëndëve narkotike, duke u kthyer në person me varësi nga këto lëndë. Sasia e lëndës narkotike e kapur të pandehurit Martin Mema është shumë e vogël.

- Faktin se, i pandehuri e ka pranuar akuzën dhe ka mbajtur një qëndrim pohues dhe pendues si gjatë hetimit ashtu dhe gjykimit.
- Faktin se, i pandehuri ka disa muaj që është duke vuajtur masën e sigurimit « arrest në burg ».
- Faktin se, i pandehuri është i rehabilituar, ka krijuar familje pasi është i martuar dhe është burimi kryesor i sigurimit të të ardhurave për jetesë.

Në këto kushte, bazuar edhe në nenet 47-50 të K.Penal Gjykata çmon se në tërësi, rrethanat e kryerjes së veprës penale nga i pandehuri Martin Mema nuk janë lehtësuese. Bazuar në faktet e renditura më sipër (*sasia e lëndës së kapur, fakti i të qenit përdorues, pendimi i thellë, mosha e re, i punësuar, etj...*) **Gjykata vëren se, ky i pandehur duhet parë si përdorues tej kufijve të parashikuara nga ligji dhe jo si person që merret me prodhimin, shpërndarjen dhe/apo shitjen e lëndës narkotike.**

Për pasojë, Gjykata vëren se, nuk është i domosdoshëm izolimi i këtij të pandehuri nga shoqëria. Sa më sipër, bazuar në nenin 283/1 i pandehuri Martin Mema duhet të dënohet *me 5 (pesë) vjet burgim*. Duke qenë se, ndaj të pandehurit Martin Mema u zhvillua gjykimi i shkurtuar, i ulet 1/3 e dënimit dhe përfundimisht i pandehuri Martin Mema dënohet *me 3 (tre) vjet e 4 (katër) muaj burgim*.

Nisur nga rrezikshmëria shoqërore e paktë, që paraqet i pandehuri në këtë rast, pasi është përdorues dhe rrezikshmëria e paktë, që paraqet vepra penale e kryer prej tij në këtë rast, pasi sasia është shumë e vogël dhe për përdorim vetjak, Gjykata çmon se, izolimi i të pandehurit nga shoqëria do të sillte një dëm shumë të madh në jetën e të pandehurit si dhe nuk do të ndihmonte aspak në arritjen e qëllimit kryesor të dënimit: edukimin dhe rehabilitimin e tij. Për pasojë, në aplikim të nenit 59 të K.Penal, dhe vënien në provë të të pandehurit për një periudhë kohore prej 3 (tre) vjetësh me kusht që gjatë kësaj kohe i pandehuri të mos kryejë veprë tjetër penale dhe të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës, i cili do të caktojë dhe mbikqyrë zbatimin e urdhërave të dhëna. Gjithashtu gjykata në bazë të pikave 9 dhe 12 të nenit 60 të K.Penal urdhëron të pandehurin që gjatë periudhës së proves të mos shoqërohet me persona të dënuar, si dhe ti nënshtrohet një programi rehabilitimi nga lënda narkotike. Afati i proves fillon nga e nesërja e shpalljes së këtij vendimi.

Në aplikim të nenit 389 të K.Pr.Penale urdhërohet heqja e masës së sigurimit **“arrest në burg”** të caktuar ndaj të pandehurit me vendimin nr.1368 akti, dt.12.08.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe lirimi i tij i menjëherëshëm nga ambjentet e paraburgimit, nëse nuk mbahet i arrestuar, i ndaluar apo i dënuar për ndonjë veprë tjetër penale.

Në aplikim të nenit 190 pika b, urdhërohet asgjесimi i : lëndës narkotike të sekuestruar të llojit kokainë në masën **2.4 (dy pike katër)** gramë; dy pjatave porcelani ngjyrë e bardhë; kartmonedhës 500 euro të falsifikuar si edhe të një peshoreje elektronike.

Në përfundim të këtij arsyetimi Gjykata çmon se, lloji dhe masa e dënimit dhënë ndaj të pandehurit Martin Mema do të vlejë për parandalimin e kryerjes së veprave penale nga ky i pandehur, edukimit dhe rehabilitimit të tij, si dhe do të shërbejë për parandalimin e krimit të **“Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”** në shoqëri.

Duke qenë se, i pandehuri u deklarua fajtor dhe u dënua për veprën penale për të cilën akuzohet, bazuar në nenin 485 të K.Pr.Penale, shpenzimet proceduriale proceduriale i ngarkohen të pandehurit Martin Mema.

**PËR KËTO ARSYE,**

Gjykata bazuar në nenet 190, 328, 331, 332, 332/c, 379, 390, 406 e 485 të K.Pr.Penale,

**V E N D O S I**

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Martin Mema** per kryerjen e vepres penale te **“Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”**, parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal dhe dënimit e tij **me 5 (pesë) vjet burgim**.
2. Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit dhe përfundimisht i pandehuri **Martin Mema** dënohet **me 3 (tre) vjet e 4 (katër) muaj burgim**.
3. Në aplikim të nenit 59 të K.Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të pjesë së mbetur pa vuajtur të dënimit me burgim dhënë sot ndaj të pandehurit **Martin Mema**, duke e vënë në provë të pandehurin për një periudhë kohe prej 3 (tre) vite me kusht, që gjatë kësaj kohe i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale dhe të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës në vëndbanimin e të pandehurit.
4. Në aplikim të pikave 9 dhe 12 të nenit 60 të KP, i pandehuri detyrohet që gjatë kohës së provës të mos shoqërohet me persona të dënuar si dhe ti nënshtrohet një programi rehabilitimi ndaj lëndës narkotike. Afati i provës fillon nga dita e nesërme.
5. Në aplikim të nenit 389 të K.Pr.Penale urdhërohet heqja e masës së sigurimit **“arrest në burg”** të caktuar ndaj të pandehurit me vendimin nr.1368 akti, dt.12.08.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe lirimi i tij i menjëherëshëm nga ambjentet e paraburgimit, nëse nuk mbahet i arrestuar, i ndaluar apo i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale.
1. Pushimin e akuzës për veprën penale **“Falsifikimi i dokumentave”**, parashikuar nga neni 183 i K.Penal, në ngarkim të të pandehurit **Martin Mema**.
6. Në aplikim të nenit 190 pika ç, aparat telefon celular tip “Samsung” model S20, një automjet “Alfa Romeo” me targa AB 207 AP, 2 kartmonedha me prerje 5000 lekëshe dhe një 2000 lekëshe, si dhe një aparat regjistruar DVR t’i kthehen pronarit të ligjshëm nëse nuk janë objekt i ndonjë konflikti tjetër.
7. Në aplikim të nenit 190 pika b, urdhërohet asgjesimi i : lëndës narkotike të sekuestruar të llojit kokainë në masën **2.4 (dy pike katër)** gramë; dy pjatave porcelani ngjyrë e bardhë; kartmonedhës 500 euro të falsifikuar si edhe të një peshoreje elektronike.
8. Shpenzimet procedurale në fazën e hetimeve paraprake në shumën 12 000 (dymbëdhjetëmijë) lekë në ngarkim të të pandehurit.
9. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 15 ditëve nga dita e njoftimit të tij në Gjykatën e Apelit Tiranë.

**U shpall në Tiranë, sot më dt.17 shkurt 2022!**

**SEKRETARE**

**JUNA SANXHAKU**

**GJYQTAR**

**GERD HOXHA**